

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Projekte rruges - loti 3 - Bashkia Malesi e Madhe

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime per projektme teknike per ndertimin e veprave ne inxhinierine e ndertimit - 71322000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

3 4 719 502 (katër milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa tvsh dhe 5 663 402 (Pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dy) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimi dhe kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektojm te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

- b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorezojë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara .
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj

është kërkuar që përvoja e mëparshme e ngjashme të jetë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose se paku 20% i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim, kategorite e meposhtme:

- Kat. 4/i - Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve, aeroporteve, etj.
- Kat. 5/c - Projektim ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.
- Kat. 6/a - Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- Kat. 6/b - Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
- Kat. 7/a - Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
- Kat. 8/a - Rilevime inxhinierike.
- Kat. 8/b - Rilevime inxhinierike kadastrale.
- Kat. 8/c - Sisteme GIS.
- Kat. 8/d - Bazamente gjeodezike.
- Kat. 9/d - Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- Kat. 11/a - Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
- Kat. 11/b - Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në dëgëzime me hekurudhën.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, vkm nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" si dhe pika 4, neni 41 I VKM 285/2021.

Kategoritë janë kërkuar bazuar ne detyren e projektimit dhe kategorite e sherbimeve qe kerkohen aty.

2.3.3. Ofertuesi duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (nje) Projektues Inxhinier Ndertimi, profili Infrastrukturë dhe Transport.

1 (nje) Projektues Inxhinier Elektrik

1 (nje) Projektues Inxhinier Gjeodet

1 (nje) Projektues Inxhinier Gjeolog

1 (një) Projektues Inxhinier Hidroteknik.

Per keta duhet te paraqiten kontratat e punes, diplomat,CV dhe licencat perkatese.

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021. Drejtuesit teknike te kerkuar ne piken 2.3.4. kerkohen ne perputhje me kategorite e licencave te kerkuara ne piken 2.3.3.

2.3.4.Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar të të paktën 9 (nente) personave, për periudhën e fundit objekt deklarimi të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek detyra e projektimit nga ku del nevoja per specialitet e fushave perkatese te cilet jane 5 drejtues teknike sipas pikes 2.3.3; 1 inxhinier sipas pikes 2.3.5 si dhe 3 specialist ndihmes per terrenin.

2.3.5. Ofertuesi për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin mbështetës, si më poshtë:

1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës (të vlefshme), si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021.

Eksperti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte i dodmosdoshem duke patur parasysh qe projektit qe do te hartohen duhet detyrimisht te shoqerohen me Raportin e Vleresimitte Ndikimit ne Mjedis.

2.3.6. Ofertuesi për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë certifikata ISO si me poshte:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** ”Sisteme të menaxhimit të mjedisit” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
3. Certifikatën SSH/ EN/UNI **45001-2023** ”Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
4. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 39001:2012** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.

Certifikatat duhet të jenë në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen dhe të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit. Në rast bashkimi operatorësh, kjo certifikata duhet të ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve sipas marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001: 2015 “Per menaxhimin e cilesise”- kjo certificate sherben per te provuar se sherbimet qe ofron ofertuesi jane ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

ISO 45001-2023“Sistemet e menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”- Kjo certificate sherben per te provuar se operatori vepron conform standarteve te miratuar te sigurise dhe shendetit ne pune qe eshte nje aspekt i rendesishem per te deshmuar se operatori nuk ka mangesi ne proceset e punes e si rrjellose as ne kryerjen e sherbimit.

ISO 14001-2015 ”Sisteme të menaxhimit të mjedisit”- kjo certificate sherben per te provuar se sherbimet qe ofron ofertuesi jane ne perputhje me standartet mjedisore.

ISO 39001:2012 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor”, kjo certificate sherben per te provuar se ofertuesi eshte i certifikuar per projektimet ne fushen e sigurise se trafikut rrugor, pasi edhe objekti i prokurimit eshte i lidhur ngusht me kete.

2.3.7. Ofertuesi për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë (në pronësi ose me qira) mjetet si më poshtë:

1(një) GPS

1(një) Total Station

1(një) Automjet tip SUV (me dokumentacion të rregullt për qarkullim).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe pajisjet e mësipërme janë kërkuar duke u bazuar në shërbimet e kërkuara në detyrën e projektimit dhe konkretisht:

1(një) GPS – sherben per percaktimin e sakte e koordinatave te objekteve, matjet topografike etj,

1(një) Total Station – sherben per matjet ne terren, kufinjte, kuotata etj.

1(një) Automjet tip SUV (me dokumentacion të rregullt për qarkullim) – shërben për të aksesuar objektet në terren pasi duke qene rruge të paasfaltuara, përbehen nga terrene të vështira dhe jo të arritshme nga mjetet e vogla të qarkullimit.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim"

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.